



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:084378

Datë: 10.02.2021

Numri i dokumentit: 01493655

**C.nr.1668/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Mirvete Alidemi, kryetare e trupit, gjyqtarëve porotë Emrush Qamili dhe Tefik Muji anëtar të trupit, në çështjen juridike të paditëses K. K e lindur A nga fshati..., të cilën e përfaqëson me autorizim Halit Azemi avokat nga Gjilani, ndaj të paditurit I. K nga nnn, rruga "... " pa numër, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jo publik, të mbajtur në prezencën e te autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, me datë 04 Shkurt 2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Martesa e lidhur para personit të autorizuar të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjilan, me dt. ..., ndërmjet:

**-Paditëses K. K- mbiemri i vajzërisë A... nga fsh. ..., Komuna e Gjilanit, e lindur më datë ..., ne fsh.... nga babai S.A dhe nëna M. A, në të cilën martesë nuk kanë fëmijë, dhe**

**- I padituri I. K i lindur me ..., në ..., nga babai Xh. K dhe nëna H. K e lindur H., në të cilën martesë nuk kanë fëmijë dhe as që priten të kenë.**

**Sh k u r o r z o h e n** në pajtim me dispozitën e nenin 68, lidhur me nenin 69.2 të Ligjit për Familjen e Kosovës.

**II.** Obligohet Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, që ta bëjë ndryshimin në Librin Amzë të Kurorëzuarve si dhe t'ia kthejë mbiemrin e vajzërisë paditëses K. A

**III.** Shpenzime procedurale i bartë pala paditëse.

**A r s y e t i m**

Paditësja K. K nga fsh ..., Komuna e Gjilanit, përmes te autorizuarit të saj me autorizim H.A avokat nga Gjilani, në këtë gjykatë me dt.14.07.2020, ka paraqitur padi për shkurorëzim kundër

të paditurit I. K nga ... Në përmbajtjen e padisë ka theksuar që palët ndërgjyqëse kishin lidhur kurorë pasi që më parë ishin njoftuar, me qëllim që në të ardhmen të jetojnë në bashkësi familjare. Mirëpo për shkak të edukatave dhe karaktereve të ndryshme, jeta e tyre e përbashkët ishte çrregulluar deri në atë masë sa që ka ardhur deri tek ndarja në mes tyre, ashtu që jeta e përbashkët nuk ishte e mundur të vazhdojë dhe definitivisht ishin ndarë gjatë vitit 2009 Përshkak të çrregullime serioze dhe të përhershme dhe nuk kishin rast më që të vazhdojnë bashkësinë e përbashkët martesore, e gjithashtu nuk kishin kurrfarë efekti juridik që edhe me tutje të egzistonte kjo martesë pasi që nuk kishin kurrfarë kontakti në mes veti që nga viti 2009 dhe nuk kishin për qëllim vazhdimin e martesës për shkak se paditësja është martuar në fshatin Ponesh ku edhe jeton. Andaj në fund i ka propozuar gjykatës që të caktojë shqyrtimin gjyqësor dhe pas administrimit të provave të merr Aktgjykim me të cilën martesën e lidhur me dt.01.07.2008 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjilan në mes paditëses dhe të paditurit, të shkurorëzohet konform dispozitave ligjore neni 68 al.1 te Ligjit mbi Familjen të Republikës së Kosovës.

Shqyrtimi gjyqësor i dt. 04.02.2021, me propozimin e të autorizuarit të paditëses është mbajtur në mungesë të të paditurit meqë i njejtë ka qenë i ftuar në mungesë të rregullt, ftesën e ka pranuar por të njejtës nuk i është përgjigjur dhe mos ardhjen nuk e ka arsyetuar ndërsa i autorizuari i paditëses ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se paditësja K. me të paditurin janë njoftuar dhe kanë lidhur kurorë me dt.01.07.2008, ku në fillim raportet bashkëshortore kanë qenë të mira por më vonë janë çrregulluar deri në atë masë sa që në vitin 2009 janë ndarë definitivisht dhe nga ajo kohë deri më tani nuk kanë kurrfarë kontakti ndërmjet veti. Paditësja pasi që është ndarë me të paditurin në vitin 2009, është martuar me A. S. nga fshati ..., kanë edhe vajzën e mitur E. She lindur me ... dhe si provë i ka propozuar gjykatës që të lexohen dhe administrohen të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe pas administrimit të tyre, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit ka administruar këto prova: Çertifikatën e martesës e evidentuar me numër rendor ... e lidhur në ZGJC në Gjilan, me dt....; Çertifikata e lindjes për fëmijun E. Sh me nr.rendor ..., e dt. së regjistrimit 20.11.2009 lëshuar në ZGJC në Gjilan; Deklarata për Bashkësinë Familjare e lëshur në Gjilan me dt.04.02.2021 me nr.rendor ....

Pas administrimit të provave materiale secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, si në kuptim të nenit 8 të LPK-ës, dhe nga rezultati i gjithmbarshëm i procedurës provuese, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se ndërgjyqësit si bashkëshortë kanë lidhur kurorë para personit të autorizuar të Zyrës të Gjendjes Civile në Gjilan, me dt. 01.07.2008, dhe se nga kjo bashkësi martesore nuk kanë pasur fëmijë dhe as që presin të kenë.

Se në fillim të krijimit të bashkësisë martesore raportet bashkëshortore kishin qenë të mira por për shkak të edukatave dhe karaktereve të ndryshme, jeta e tyre është çrregulluar deri në atë masë sa që të njejtë ishin ndarë definitivisht në vitin 2009 dhe që nga ai vit e tutje të njejtë nuk

kanë pasur kurrfarë kontakti mes veti pasi që paditësja është martuar në fshatin ... ku edhe jeton dhe nga kjo martesë ka të lindur një vajzë.

Këto fakte vërtetohen nga Çertifikata e martesës e evidentuar me numër rendor ..., e lidhur në ZGJC në Gjilan, me dt.01.07.2008.

Nga Çertifikata e lindjes për fëmijun Elina Shala me nr.rendor ..., e dt. së regjistrimit 20.11.2009 lëshuar në ZGJC në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se vajza është e lindur nga babai Avdush Shala dhe e ëma K. A

Nga Deklarata për Bashkësinë Familjare e lëshur në Gjilan me dt.04.02.2021 me nr.rendor ..., gjykata vërtetoi faktin se paditësja K. K e lindur Ajeton në bashkësi familjare me bashkëshortin A. Sh dhe vajzën E. Sh

Gjykata pasi analizoi këto prova materiale, e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar me ligj, pasi që me jetë të ndarë bashkëshortore dhe me çrregullime serioze të marrëdhënieve bashkëshortore nuk mund të arrihet qëllimi shoqëror i martesës që është bashkëjetesa e përbashkët.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që e obligoi Zyrën e Gjendjes Civile në Gjilan, që ta bëjë ndryshimin në Librin Amzë të Kurorëzuarve, si dhe paditëses K. K t'ia kthejë mbiemrin e vajzërisë A.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur konform nenit 452.4 të LPK.

Prandaj, gjykata konform nenit 68 lidhur me nenin 69.2 të Ligjit për Familje të Kosovës lidhur me nenin 143 dhe nenin 349 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,  
Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil,  
C.nr.1668/2020, me datë 04 Shkurt 2021**

**Kryetarja e trupit –gjyqtarja;  
Mirvete Alidemi**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë Gjyqatese se Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë pas ditës së pranimit të vendimit, përmes kësaj gjyqate.